



Qershor 2022

Nr.6

ASHMA mbajti takimin e dytë publik për vitin 2022



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 29.06.2022 ka mbajtur takimin e dytë publik për këtë vit, në të cilin drejtori i Agjencisë dr.Zoran Trajçevski bëri elaborim të aktiviteteve të realizuara në përputhje me Planin Vjetor për punën në tremujorin e kaluar. Pjesëmarrësit patën rastin të dëgjojnë për aktivitete lidhur me mbikëqyrjet e kryera ndaj transmetuesve, operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik, ofruesit e ASHMA-së sipas kërkesës, botuesit e medias së shkruar, hulumtimet e bëra, aktivitetet në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në takim u prezantuan dhe të dhënat për dispozitat ligjore që transmetuesit në 2021 dhe gjysmën e parë të vitit 2022 më së shpeshti i kanë shkelur dhe procedurat kundërvajtëse të inicuar nga Agjencia. Shkelje më të shpeshta siç theksoi dhe mr. Ivona Myfisheva nga Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik i referohen detyrimeve të transmetimit të programit të krijuar burimor, mos publikim të informacioneve të cilat duhet të vihen në dispozicion të përdoruesit dhe rregullat për mbrojtjen e të miturve. Lidhur me këtë temë u zhvillua një diskutim i hapur ku siç theksoi dhe zëvendës Kryetari i Këshillit të Agjencisë z.Selver Ajdini, ka për qëllim të përcaktojë shkaqet e shkeljeve dhe të japë rekomandime të cilat radiot dhe televizionet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë në të ardhmen për të rritur shkallën e respektit ndaj detyrimeve ligjore. Për zbatimin aktual të rregullativës mediatike dhe propozimet për ndryshim në drejtim të përmirësimit të situatave në mediat lokale dhe rajonale foli dhe Dimitar Micev nga TV Kanal Vis.Në veçanti u theksua nevoja e krijimit të një fondi për mediat, anulimin e ndalesës për reklamim sipas nenit 102 nga LSHMAAV, gjatë e larta,rregullat për dhënien e lejeve për transmetim në radio dhe television. U parashtua dhe pyetja për gjendjen e rënduar financiare në të cilën ndodhen mediat dhe mundësitë për të ofruar mbështetje për punën e tyre.

Përfaqësues të OSBE-së/ODIHR-së në një vizitë pune në ASHMA



Me 23 qershor një delegacion i OSBE-së/ODIHR-së bëri sot një vizitë pune në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ku u diskutua për vëzhgimet e vërejtura në raportin përfundimtar të misionit vëzhgues për Zgjedhjet vendore 2021 dhe rekomandimet që dolën prej tij.Ndër të tjera, theksi u vu në financimin e fushatës, sigurimi i aksesit në programet e transmetuesit të personave me aftësi të kufizuara shqisore dhe mospërputhjeve të shumta në kuadrin ligjor zgjedhor.Nga ana e Agjencisë u shkëmbyen përvoja nga monitorimi i realizuar gjatë raportimit zgjedhor të transmetuesve, dhe u bisedua për propozimet për ndryshimin dhe përmirësimin e sistemit zaidhor.

U mbajt punëtori për dhunën me bazë gjinore dhe standardet profesionale për raportimin gazetaresk



Nën organizim të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe në bashkëpunim me Koalicionin Margini dhe Rrjetin Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, më 9 qershor në hapsirat e Agjencisë u mbajt punëtori me temë "Dhuna me bazë gjinore dhe standardet profesionale për raportimin gazetaresk". Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtori i Agjencisë, Dr. Zoran Trajçevski, iu referua Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur si Konventa e Stambollit. Punëtorja e sotme është realizuar si obligim i rregullatorit në përputhje me Planin e Veprimit për zbatimin e tij.

Drejtoresha Ekzekutive e Koalicionit Margini, Dr.Irena Cvetkoviq, foli për qasjen Ndërsektoriale të Trajtimit të Dhunës në Bazë Gjinore, Këshilltarja e së drejtës Ana Avramoska Nushkova e prezantoi Legjislacionin kombëtar ekzistues dhe sistemi i mbrojtjes së grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Ekspertja për media Dr. Marina Tuneva shpjegoi para të pranishmëve Manualin për raportim të ndjeshëm gjinor në media, ndërsa ndihmës shefe e Sektorit për Çështje Programore në ASHMA-së Mr. Emilija Petreska-Kamenjarova iu referua Udhëzuesit të ASHMA-së për Monitorimin e Raportimit të dhunës me bazë gjinore.Kjo punëtori u dedikua punonjësve profesionistë të medias dhe në të morën pjesë përfaqësues të radiove dhe televizioneve kombëtare.

Dënim për fyerje verbale drejtuar gazetares së TV Telma

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale me 29 qershor i dënoi qëndrimin e papërshtatshëm të këshilltarit në komunën e Ohrit, Nefi Yseini ndaj korrespondentes së televizionit Telma. Bartësit e funksioneve publike janë subjekt mbikëqyrës për publikun dhe në kritika potenciale të forta publike përmes medias,për këtë shkak ata duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e çdo fjale të thënë dhe të përmbahen nga çdo lloj komunikimi të papërshtatshëm dhe të pakëndshëm.

Agjencioni ka apeluar vazhdimisht që tu mundësohet gazetarëve të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale,mbi të gjitha, duke pasur parasysh rolin e tyre në ngritjen e çështjeve me interes publik dhe sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së organeve politike dhe publike.



NEWSLETTER

Pronësia e medias në 2022

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale përgatiti [publikimin për pronësinë e medias në vitin 2022](#), për sigurimin e një transparence më të madhe për pronësinë e medias, duke shfrytëzuar të dhëna zyrtare mbi strukturën e pronësisë së transmetuesve nga Regjistri Qendror i RS Maqedonisë, për botuesit e medias së shkruar dhe të dhëna nga shpalljet në gazetën ditore (përditëshme) të cilat i kryenin në kuadër të përmbushjes së detyrimit ligjor për të ofruar transparencë të punës.

Në këtë publikim, i katërti me radhë i këtij lloji, në pjesë të veçanta janë paraqitur të dhëna për pronarët e televizioneve dhe radiostacioneve, si dhe botuesit e medias së shkruar në vitin 2022.

Të dhëna për shtrirjen e radiostacioneve dhe përqindjen në total të shikueshmërisë së stacioneve televizive për periudhën janar-maj 2022

Për nevojat e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ishte kryer [hulumtim mbi shtrirjen e radiostacioneve dhe për pjesën e shikueshmërisë totale të stacioneve televizive, për periudhën janar-maj 2022](#).

Të dhënat janë marrë përmes një anketimi të opinionit publik dhe i referohen: shtrirjes mesatare ditore dhe javore të dëgjimit të radiostacioneve dhe shikueshmërisë televizive; periudhë nga dita kur të anketuarit dëgjonin radio/shikonin televizor; llojin e përmbajtjes së programit që dëgjuan/shikuan një ditë më parë; pjesëmarrja e shikueshmërisë totale e një dite më parë, dhe pjesëmarrja e shikueshmërisë në territorin ku televizionet transmetojnë program dhe pjesëmarrja në shikueshmëri totale; arrija mesatare ditore dhe javore e televizioneve të huaja dhe të tiera.

Mbikëqyrje kundrejt radiodifuzerëve, operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik, mediat e shtypit dhe ofruesit e ASHMA-së me kërkesë

Radiodifuzerët

Në pajtueshmëri me Planin vjetorë për mbikëqyrje programore për vitin 2022, dhe në nildhje me obligimet nga Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale (LSHMAAV) dhe nga aktet nënligjore, Agjencia realizoi mbikëqyrje e rregullt programore kundrejt pesë radiodifuzerëve në nivel rajonal Rosa-AB, Zona-M1, Skaj Radio, EF-EM 90.3-Radio Sportive dhe RA RFM. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale realizoi mbikëqyrje të rregullt programore kundrejt 12 televizioneve 24 Vesti, Alfa TV, TV Kanal 5, TV Klan Macedonia, TV 21, Nasha TV, TV Alsat-M, TV Telma, TV Shenja, TV Sitel, TV Sonce dhe MRT 1 për obligimin që gjatë vitit më së paku të sigurojnë 51% ndërsa MRT 1 60% nga gjithsejtë emetimi i programve të jetë vepra audiovizuale evropiane. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore të LSHMAAV.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale sipas detyrës zyrtare ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative ndaj Radio Llav nga Ohri. Nga mbikëqyrja e jashtëzakonshme administrative u konstatua se Radio Llav, ka ndaluar transmetimin në radio të shërbimeve programore për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare dhe arsye të tjera, që është bazë për heqjen e lejes për transmetim në radio, në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 alinea 2 nga LSHMAAV.

Operatorët të rrjetit publik të komunikimit elektronik

Për obligimet e operatorëve të RRPKE në pakot programore të cilët i reemitojnë detyrimisht dhe pa pagesë ti sigurojnë serviset programore të shërbimit publik, si dhe për obligimet për regjistrimin e serviseve programore në Agjenci dhe titërimi i programeve të cilat i rremitojnë është realizuar mbikëqyrje e rregullt programore kundrejt operatorit Viva Net, Mtel, Total TV, Kanal 16, Neotel dhe A и A1 Македонија. Me mbikëqyrjen u konstatua se në pakon e serviseve programore nuk i ka siguruar serviset programore të shërbimit publik „MRT 2“, „MRT 3“, „MRT 4“ dhe „MRT 5“..

Kundrejt operatorit të Antena AS KTV nga Kërçova, Agjencia realizoi mbikëqyrje e rregullt programore për të konstatuar në paraprakisht shqiptimi i masës, dërguar përshkak të reemetimit të serviseve programore të cilat nuk janë regjistruar në Agjenci. Me mbikëqyrjen u konstatua se operatori në kundërshtim me në pakon e vetë programore reemeton servisin programor RTCG Sat, i cili nuk është regjistruar në Agjenci.



NEWSLETTER

Ofruesit e ASHMA-së me kërkesë

Për detyrimet që lidhen me transmetimin e veprave kinematografike, mbrojtjen e të miturve dhe promovimin e produkteve dhe aksesin në veprat evropiane, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore ndaj ofruesit të ASHMA-së me kërkesë nga Neotel, Makedonski Telekom dhe Svod Master. Gjatë mbikëqyrjes së kryer programore nuk janë konstatuar shkelje.

Mediat e shtypit

Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj Repro Pring botues i „Nova Makedonija“, Sloboden Peçat botues i „Sloboden Peçat“, Veçer Pres botues i „Veçer“, Koha Produksion botues i „Kohës“, Kapital Media Grup botues i „Kapital“, Media Plus Fokus botues i „Fokusit“, Media Pres VM botues i „Bitollski vesnik“, Jeni ballkan botues i „Bahçes“, ATV Media Kompani botues i „Lajmit“, Euro-Mak Kompani botues i „Ekonomija i Biznis“, Antiq media botues i „Portret“, Medium Boja 43 botues i „Shtipski Gllas“, Kolor media plus botues i „Ubavina i zdravje“ dhe „Ruski doktor“, Biro Pres botues i „Porta 3“, Vizioni M botues i „Shenjës“, Zenit Pres Plus botues i „Zenit“, Pablik „Lice v lice“ dhe Kliker marketing botues i „Instores“ ku synon të konstatojë nëse kanë publikuar të dhëna për emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së medias së shkruar, të dhëna për personin përgjegjës, redaktorët, shtypshkronjën, datën e botimit ose të ribotimit dhe numrin e botimeve, në pajtueshmëri me detyrimet nga Ligji për media. Nga mbikëqyrja u konstatua se mediat e shkruara të përfshira në mbikëqyrje e kanë përmbushur këtë detyrim.

Shqiptimi I masave vërejtje publike

Në seancën e 23-të e mbajtur më 14 qershor 2022, Këshilli i Agjencisë shqiptoi masa vërejtje publike për operatorët A1 Makedonija dhe Total TV. Masë vërejtje publike operatorit A1 Makedonija iu shqiptua përshkak të reemetimit të servise programore të cilët nuk janë mbuluar me vërtetimet për regjistrimin e serviseve programore lëshar nga Agjencia.

Operatorit Total TV masë vërejtje publike iu shqiptua përshka se në pakon e servise programore nuk i ka siguruar serviset programore tëshërbimit publik „MRT 2“, „MRT 3“, „MRT 4“ dhe „MRT 5“.

Në seancën e 21 të mbajtur me datë 27 maj 2022, Këshilli i Agjencisë i shqiptoi masë vërejtje publike operatorit Antena AS KTV nga Kërçova përshkak të reemetimit të servisit programor „Russia Today Documentary“ ici nuk ishte përfshir me vërtetim për regjistrim të servisit programor të lëshuar nga Agjencia.

Në seancën e 23-të e mbajtur më 14 qershor, Këshilli i Agjencisë shqiptoi masë vërejtje publike kundër operatërëve АСоветот на Агенцијата изрече мерка јавна опомена Мakedonija dhe Total TV на операторите А1 Мakedонија и Тотал ТВ. Јавна опомена на операторот А1 Мakedонија беше изречена заради реемитување на програмски сервиси кои што не се опфатени со потврдата за регистрација на програмски сервис издадена од Агенцијата. За Тотал ТВ јавна опомена е изречена заради тоа што во својот програмски пакет ги нема обезбедено програмските сервиси на јавниот радиодифузен сервис „MPT 2“, „MPT 3“, „MPT 4“ и „MPT 5“.

